



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17-3/2021 regjistër (JR)
Datë 14.12.2022

Nr. 10 i vendimit
Datë 28.02.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.02.2025, ditën e premte, në orën 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Griselda Muça, çështjen që i përket:

KËRKUES: Bilbil Mete, lindur në {***} dhe banues në rrugën “{***}”, Njësia Bashkiake Nr. {***}, {***}, Tiranë.

OBJEKTI: Rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe shfuqizimin e pikës nr. 2 të dispozitivit të vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si të pabazuar në ligj e në prova.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 1, 5, 35, 42, 48, 52, 122, 142, 148 e vijues, si dhe nenet F dhe G të Aneksit të saj;
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nenet 1, 6, 7, 13;
Kodi i Procedurës Civile, nenet 494 e vijues;
Kodi i Procedurave Administrative;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 7730, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 31 dhe 92;

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 57 e vijues;

Vendimi nr. 34, datë 10.04.2017, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, vlerësoi mbi juridiksionin e Kolegjit për shqyrtimin e saj, por edhe konsideroi pretendimet e kërkuarit për rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Bilbil Mete (në vijim kërkuari) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në zbatim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, me vendimin nr. 322, datë 10.12.2020, vendosi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe ndalimin e emërimit të z. Bilbil Mete, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Këtë vendim kërkuari e ankmoi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), i cili mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike shkaqet e ankimit të pretenduara nga z. Mete dhe me vendimin nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Në vendimin nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, shumica e trupit gjykues të Kolegjit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Bilbil Mete ndodhet në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes nga detyra e prokurorit, për rrjedhojë gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e Komisionit në pikën 2 të dispozitivit të tij, që disponon sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
3. Kërkuari Bilbil Mete ka paraqitur në Kolegji kërkesë për rishikimin e vendimit të formës së prerë me nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në të cilën ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 3.1. Kërkuari shpjegon se vendimi i Komisionit, si dhe vendimi i Kolegjit janë bazuar në vendimin nr. {***}, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”). Nëpërmjet këtij vendimi, KLP-ja ka disponuar “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, mbështetur në nenin 64, pika 1, germa “a” dhe nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, duke vendosur deklarin e mbarimit të statusit, për shkak dorëheqje, të magjistratit Bilbil Mete. Kundër këtij

vendimi, kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar ndryshimin dhe plotësimin e dispozitivit të tij si vijon: “Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit Bilbil Mete, për shkak të daljes në pension pleqërie”, pasi në këtë rast pala paditëse (kërkuesi) ka kërkuar nga KLP-ja përfundimin e statusit të magjistratit, për shkak se ka mbushur moshën për të përfituar pension pleqërie. Kërkuesi shpjegon se cilësimi i bazës ligjore të përcaktuar në kërkesën e drejtuar KLP-së, si dhe arsyet e parashtruara në të, tregojnë se pala paditëse kërkon përfundimin e statusit dhe mosvijimin e ushtrimit të funksionit pikërisht për këtë shkak. Interpretimi i kërkesës së paraqitur nga KLP-ja, si kërkesë për heqje dorë nga statusi i magjistratit, në kushtet kur kërkesa nuk e parashikon shprehimisht dhe në mënyrë të qartë një gjë të tillë, përbën tejkalim të kompetencave të KLP-së në ushtrimin e funksioneve të saj kushtetuese dhe ligjore. Heqja dorë nga statusi i magjistratit duhet miratuar nga Këshillat vetëm në ato raste kur kërkesa përmban në mënyrë të shprehur, qartë dhe pa asnjë ekuivok, vullnetin e magjistratit për të mos vijuar më tej ushtrimin e profesionit.

3.2. Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin nr. {***}, datë 23.12.2020, vendosi rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj. Kundër këtij vendimi, kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 25.10.2022, ndër të tjera, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 13.12.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, pranimin e pjesshëm të padisë, ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 15.10.2020, të KLP-së, për pjesën e motivacionit që lidhet me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak dorëheqje.

3.3. Kërkuesi pretendon se në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për pjesën e motivacionit që lidhet me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak dorëheqje, vendimi nr. 322, datë 10.12.2020, i Komisionit, si dhe vendimi nr. 9/2021, datë 23.03.2021, i Kolegjit, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit, bëhen të cenueshëm.

3.4. Në përfundim, z. Bilbil Mete, mbështetur në vendimin nr. {***}, datë 25.10.2022, të Gjykatës së Lartë, kërkon rishikimin dhe ndryshimin e vendimit të Kolegjit nr. 9/2021(JR), datë 23.03.2021 dhe shfuqizimin e pikës nr. 2 të dispozitivit të vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit, si të pabazuar në ligj e në prova.

II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

4. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: (a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (b)

ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Në vijim të sa më sipër, i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.

5. Kolegji në vendimmarrje të mëparshme ka elaboruar qëndrimin e tij mbi juridiksionin e tij rishikues¹, duke arritur në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Më tej, ka arsyetuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplicit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuarit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së sipërcituar, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016, nëse nëpërmjet tyre mund të ushtrohej ky juridiksion rishikues i pretenduar nga kërkuari.
6. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, trupi gjykues risjell në pah sërish të njëjtin arsyetim ligjor për sa i përket juridiksionit të tij rishikues, i cili mbështet në argumentet si vijon. Në këndvështrim të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të parashikohet në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në zbatim të nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilit dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Në vendimin e sipërcituar, të cilën trupi gjykues po e sjell si referim në këtë çështje, duke transpozuar qëndrimet që janë mbajtur në të për aq sa janë të zbatueshme edhe në këtë rast, është marrë në analizë nëse ndërtimi i këtij mekanizmi kontrolli të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë vjen në përputhje me qëllimin e legjislatorit edhe në rastin konkret, lidhur me tagrat e atribuuar organeve të rivlerësimit dhe posaçërisht Kolegjit. Trupi gjykues, në vendimin e referuar më sipër, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
7. Kolegji ka arsyetuar, ndër të tjera, se në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, germa “b” e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëjnë pjesë në aktet normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u renditur në hierarkinë e ligjeve

¹ Shih vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y.

pas Kushtetutës së vendit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut së bashku me mekanizmat e saj zbatues garanton zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenet 17 e 42 të Kushtetutës. Nën optikën e këtij rregulli, është miratuar edhe e drejta e subjekteve të rivlerësimit për t'iu drejtuar GjEDNj-së si i vetmi mjet procedural që ato kanë në mbrojtje të të drejtave të tyre të pretenduara si të cenuara, e cila gjen pasqyrim në parashikimin e nenit F, pika 8² e Aneksit të Kushtetutës.

8. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që edhe Shqipëria është palë.
9. Në përputhje dhe në harmoni me interpretimin e mësipërm të dispozitave vijnë edhe rregullat procedurale që parashikojnë institutin e rishikimit. Në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në germën “ë”, parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive. Kushtetuta në nenin 122 përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNj-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjithë organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjithë niveleve, po ashtu, edhe gjykatat me juridiksion specifik siç është Kolegji. Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar vëzhgohet dhe monitorohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Roli dhe kompetencat e këtij organizmi jovendimmarrës janë garanci e shtuar për mbrojtjen e interesave të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe kryerjen e tij në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 germa e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së, që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

² Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

10. Në përfundim, sipas analizës së dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës³, sipas analizës harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi sërish se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
11. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuesit, Bilbil Mete, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim, ndaj kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuesi bën në nenin 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile. Për sa më lart, kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Bilbil Mete nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksion rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë kjo kërkesë konsiderohet nga trupi gjykues si e papranueshme.
12. Gjithashtu, në kuadër të një vlerësimi garantist dhe shterues në drejtim të shmangies së çdo cenimi të mundshëm të ndonjë të drejte të kërkuesit, trupi gjykues si *obiter dictum*, konsideroi edhe pretendimet e kërkuesit, në kuptim të nenit 494, pika 1, germa “d” e Kodit të Procedurës Civile. Analiza sintetike e këtyre pretendimeve u pa e nevojshme prej trupit gjykues të bëhet pjesë e këtij arsytimi, jo si baza mbi të cilën trupi gjykues mori vendimin në rastin konkret, por për të mbështetur në thelb vendimmarrjen e tij, si të pacenueshme edhe në drejtim të themelit të saj, dhe për të komunikuar publikisht pabazueshmërinë e pretendimeve të kërkuesit edhe në versionin e shtruar prej tij.
13. Në këtë kontekst, rezulton se vendimi i Kolegjit, i cili kërkohet të rishikohet, nuk është mbështetur thelbësisht në vendimet e KLP-së apo Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, të cilat duket se janë ndryshuar prej vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 25.10.2022, por në analizën e vullnetit të subjektit për t’u dorëhequr nga detyra, si kusht i aplikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, analizë e konsoliduar në një sërë vendimesh të marra nga Kolegji. Në çështjen e rivlerësimit të kërkuesit, analiza për qartësinë dhe plotësinë e vullnetit të tij për të lënë detyrën, jo për shkak të plotësimit të ndonjë kondicioni ligjor, siç ishte plotësimi i moshës për pension, në rastin e kërkuesit, por vetëm dhe ekskluzivisht për shkak të dëshirës së tij për

³ Vendimi nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y.

të mos qenë më në detyrë, ndërsa ligji ja parashikonte, është zhvilluar në detaje dhe plotësisht në vendim dhe ka shërbyer si baza në të cilën Kolegji ka marrë vendimin objekt kontestimi.

14. Vendimi i KLP-së dhe ai i Gjykatës së Apelit Administrativ, që konfirmonin vullnetin e tij për deklarimin e mbarimit të statusit, kanë pasur në proces vlerën provuese për faktin që subjekti nuk gëzonte më statusin e magjistratit dhe se kjo rrethanë do të duhej të konsiderohej në funksion të mënyrës se si do të zhvillohej procesi i tij i rivlerësimit, por jo detyrimisht përcaktimin e shkakut që kishte shkaktuar këtë mbarim. Analiza mbi shkakun dhe nëse ai ishte apo jo dorëheqje është trajtuar prej Kolegjit si një diskrecion i organeve të rivlerësimit në të cilin nuk mund të ndërhyjnë qëndrimet e gjykatave të sistemit të juridiksionit të zakonshëm. Elementi i rëndësishëm për Kolegjin dhe me ndikim për zgjidhjen e çështjes në kohën e gjykimit të saj do të ishte vetëm rasti kur gjykatat do të vendosin se statusi i subjektit nuk kishte përfunduar dhe ai do të duhej, për pasojë t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit. Kjo rrethanë nuk ka ndodhur dhe as është pretenduar ndonjëherë prej kërkuesit. Në këtë kuptim, neni 494, paragrafi 2, germa "d" i Kodit të Procedurës Civile⁴, në të cilën duket se kërkuesi mbështet kërkesën, nuk mund të gjejë zbatim.
15. Për më tepër, në këtë kontekst, në paragrafin 35⁵ të vendimit, që kërkohet të rishikohet, trupi gjykues sjell në vëmendje se vetë kërkuesi e ka paraparë procesin e tij në Kolegj si të pavarur dhe të pandikuar prej fatit që do të kishte rekursi i paraqitur prej tij në Gjykatën e Lartë.
16. Për sa më lart, pavarësisht analizës dhe qëndrimit mbi juridiksionin rishikues të Kolegjit që pengon marrjen në shqyrtim të kërkesave të kërkuesit, trupi gjykues konfirmon se, ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit Bilbil Mete nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsytimit të mësipërm, sërish konstatohet se do të vlerësoheshin njësoj të pabazuara edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor mbi argumentet e përshkruara më lart. Në këto kushte, trupi gjykues nënvizon faktin se edhe nëse do të abstragohej nga mungesa e juridiksionit rishikues, kërkesa e kërkuesit për rishikimin e vendimit do të ishte njësoj e papranueshme.
17. Për sa më lart, trupi gjykues konfirmon, edhe në fund të këtij arsytimi dhe analize, qëndrimin se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Bilbil Mete nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germa "ë" e Kodit të Procedurës Civile, si dhe nuk gjendet në kushtet e nenit 494, germa "d" e këtij Kodi, për pasojë ajo konsiderohet e papranueshme.

⁴ d) Vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur.

⁵ Përpos parashikimeve ligjore, edhe vullneti i subjektit të rivlerësimit ishte që gjykimi të vazhdonte dhe çështja të zgjidhej prej Kolegjit, sepse shkaku ligjor i ankimit, zbatimi i nenit 164 të ligjit nr. 96/2016, sipas këndvështrimit të tij, nuk ishte ngritur në rekurs dhe mbi këtë argument Kolegji duhej të pranonte ankimin e tij. Gjatë seancës gjyqësore publike, subjekti u shpreh konkretisht se: "[...] kjo çështje mund të zgjidhet pa u shqyrtuar çështja në Gjykatën e Lartë, ku, me ritmet që po ecin, mund të vazhdojë për shumë vite, dhe unë nuk ka pse të jem i penalizuar për shkak të mosfunksionimit të Gjykatës së Lartë, sepse nuk kanë asnjë lidhje. [...] ajo që është esenciale në rekursin që po dorëzohet ka lidhje me faktin që aty nuk përmendet neni 164 dhe nuk ka lidhje fare me thelbin e gjykimit në KPA".

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Bilbil Mete, për rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.02.2025.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi -kundër

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me vendimin nr. 10 (JR), datë 28.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) për: *“Mospranimin e kërkesës së kërkesit Bilbil Mete për rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”,* por me një arsyetim ndryshe, lidhur me arsyet se përse kjo kërkesë për rishikim nuk duhet pranuar nga Kolegji, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Qëndrimi im ndryshe i referohet arsyetimit të shumicës së trupit gjykues, në paragrafin nr. 10, të vendimit, në të cilin thuhet se: *“Në përfundim, sipas analizës së dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës, sipas analizës harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi sërish se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përqijje të ankimit të vetë kërkesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”.* Pa rënë në përsëritje, sjell në vëmendje qëndrimin tim në çështjet e ngjashme të trajtuara në Kolegji, se zbatimi i vendimit të GjEDNj-së bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur zbatimi i vendimit kërkon nxjerrjen e një ligji të posaçëm nga autoritetet ligjbërëse të vendit tonë. Ligjvënësi në asnjë dispozitë kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme të procesit të rivlerësimit kalimtar nuk e ka parashikuar këtë mjet të jashtëzakonshëm ankimi e, për pasojë, mungesa e një rregullimi ligjor të shprehur të juridiksionit rishikues të Kolegjit e ndalon këtë të fundit nga shqyrtimi i kërkesave për rishikimin e vendimeve të tij.
3. Unë, gjyqtarja me mendim paralel, vlerësoj se mbetet detyrë pikërisht e ligjvënësit për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke rishikuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përfshirjen e parashikimeve ligjore, duke përcaktuar gjykatën kompetente dhe procedurat respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit në raport me të gjitha rrethanat e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Në kushtet kur ligjvënësi nuk i ka atribuuar Kolegjit juridiksion rishikues, ndaj mendimin se ky institucion nuk mund të ushtrojë këtë tagër vendimeve të tij.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, në çështjen që i përket kërkesës së z. Bilbil Mete, për rishikimin e vendimit të formës së prerë me nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pra, për pranimin e saj, për sa parashtruar në vijim.
2. Shumica e trupit gjykues në përfundim ka konkluduar se *Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.*
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [në vijim “ligji nr. 84/2016”] dhe legjislacionit në fuqi, në këtë çështje kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile⁶, ndaj duhet të kishte pranuar këtë kërkesë dhe, për rrjedhojë, të kishte hapur shqyrtimin gjyqësor lidhur me të. Ky qëndrim bazohet në argumentet si vijojnë.
4. Referuar përcaktimit të nenit F, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit [në vijim “Kolegji”] është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit [në vijim “Komisioni”] dhe zgjidh çështjen përfundimisht në sistemin e brendshëm gjyqësor.

4.1 Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit u ngrit me qëllim garantimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te ky sistem. Ligjvënësi në nenin 179/b të Kushtetutës, si dhe në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar se procesi i rivlerësimit kalimtar kryhet në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit. Kolegji si gjykata e vetme e procesit të rivlerësimit shqyrton dhe konkludon në vlerësim të shkaqeve të ankimit, si gjykatë fakti bazuar në provat dhe ligjin e zbatueshëm, por edhe si një gjykatë që gjatë shqyrtimit të ankimit garanton të drejtat dhe liritë themelore, si dhe një proces të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit.

⁶Të njëjtin qëndrim kam mbajtur dhe për kërkesën e z. A. Y., për rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se: “ [...] Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën ”⁷.

4.2 Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve në dispozitat kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016 ka konfiguruar një gjykatë e cila zbaton të gjitha garancitë procedurale të një gjykate fakti, duke përthithur në të njëjtin gjykim dhe shqyrtimin e çdo pretendimi që do të paraqitej në kuadër të një ankimi kushtetues individual. Përcaktimi i mësipërm kushtetues dhe ligjor dëshmon për një vullnet të ligjvënësit për garantimin e parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe detyrimeve që burojnë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në vijim KEDNj].

Në konsideratë të sa më sipër, kam vlerësuar se Kolegji, si gjykata e vetme e procesit, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, garanton gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit, përfshirë dhe të drejtën për akses në gjykatë, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së. Ashtu siç edhe ka theksuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në vijim GjEDNj], e drejta për akses në gjykatë duhet të jetë “konkrete dhe efektive”, ndërkohë që efektshmëria e së drejtës për akses kërkon që një individ të “gëzojë mundësinë e qartë dhe konkrete për të kundërshtuar një ndërhyrje në të drejtat e tij”⁸. Në zbatim të jurisprudencës së GjEDNj-së, e drejta për të ankimuar një ndërhyrje në të drejtat e një individi, si dhe zgjidhja e çështjes në gjykatë garantohet, ndër të tjera, edhe nëpërmjet njohjes së të drejtës për mjete efektive të ankimit, qofshin ato të zakonshme apo edhe të jashtëzakonshme.

4.3. Neni 43 i Kushtetutës garanton të drejtën e ankimit, si një nga të drejtat themelore të individit, e cila mbi bazën e parashikimit kushtetues gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale të legjisllacionit në fuqi. Kushtetuta garanton të drejtën e ankimit, duke mbajtur parasysh si sigurinë juridike edhe parashikueshmërinë e sistemit juridik, me qëllim që palëve t’u sigurohet ankim efektiv, për çdo cenim të drejte/interesi të ligjshëm, si dhe për një zgjidhje të drejtë të çështjes. Sa i përket parimit të parashikueshmërisë dhe qartësisë së sistemit të së drejtës për të shfrytëzuar mjetet e ankimit, çdo individ duhet të ketë mundësinë dhe qartësinë për mjetet e mundshme të ankimit dhe kushtet që duhet të plotësojë për ushtrimin e tyre në interes të tij.

5. Në vijim të sa më sipër, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në një analizë harmonike të nenit A dhe nenit F, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, me parashikimet e neneve 4, 6, 63, 64 e 65 të ligjit nr. 84/2016, subjekteve të rivlerësimit u njihet e drejta për akses në gjykatë bazuar në legjisllacionin në fuqi, jo vetëm për të ankimuar vendimet e Komisionit pranë Kolegjit, por edhe për të ushtruar rishikimin si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, ndaj një vendimi të gabuar të Kolegjit dhe për një zgjidhje të drejtë të çështjes së tyre. Për rrjedhojë, Kolegji ka juridiksion rishikues dhe kompetencë për të kontrolluar vendimin e tij, bazuar në rrethanat e përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile.

⁷ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, paragrafi 68.

⁸ Bellet kundër Francës, paragrafët 36 dhe 38, Nunes Dias kundër Portugalisë (déc.).

5.1. Ligjvënësi në nenin A të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar se: *“Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës”*. Në përcaktimet e nenit A të Aneksit të Kushtetutës, ligjvënësi ka pasur në konsideratë se kufizimi apo ndalimi i një të drejte themelore apo një garancie procedurale të mbrojtur nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, duhet të bëhet me ligj, bazuar në nenin 17 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të parimit të sigurisë juridike, por dhe të parashikueshmërisë për mjetet efektive.

Nga parashikimi i mësipërm i Aneksit të Kushtetutës nuk evidentohet që ligjvënësi të ketë kufizuar apo ndaluar në mënyrë eksplicite rishikimin si një mjet efektiv i jashtëzakonshëm i ankimit, ashtu siç ka bërë për të drejta të tjera, si ajo e parashikuar në nenin 131, nënparagrafi “f” për ankimin kushtetues individual pranë Gjykatës Kushtetuese. Krejt ndryshe duket se ka vepruar ligjvënësi lidhur me institutin e *“barrës së provës”*, për të cilin jo vetëm ka parashikuar kufizimin në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, por edhe ka detajuar në nenin Ç, pika 5 të tij, që në këtë proces barrën e provës e ka subjekti i rivlerësimit dhe, më tej, në nenin 52, paragrafi 3 të ligjit nr. 84/2016, ka përjashtuar në mënyrë eksplicite zbatimin e nenit 82 të Kodit të Procedurës Administrative. Këto parashikime për institutin e *“barrës së provës”* dëshmojnë se nëse ligjvënësi kishte për qëllim të ndalonte të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një mjet efektiv të jashtëzakonshëm ankimi, siç është rishikimi i vendimit, ai ka qenë i qartë për mënyrën si duhet të normohej ndalimi apo kufizimi i një të drejte apo garancie procedurale në kuadër të procesit të rivlerësimit.

5.2. Gjithashtu, rezulton se kufizimi apo ndalimi për rishikimin e vendimit si një mjet efektiv ankimi nuk është parashikuar edhe në asnjë dispozitë të ligjit nr. 84/2016. Ligjvënësi në nenet 62, 63, 64 e 65 të ligjit nr. 84/2016, ka rregulluar në mënyrë të posaçme vetëm mjetin e zakonshëm të ankimit, duke përcaktuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave subjektet procedurale që mund të ushtrojnë këtë të drejtë, organin pranë të cilit depozitohet ankimi, afatet në të cilat ushtrohet kjo e drejtë, procedurën e njoftimit të ankimit etj. Mosparashikimi në mënyrë eksplicite në ligjin nr. 84/2016 i të drejtës për rishikimin e vendimit të Kolegjit, nuk duket se ka pasur për qëllim kufizimin apo ndalimin e kësaj të drejte për subjektet e rivlerësimit, përkundrazi kam vlerësuar se mungesa e një rregullimi të posaçëm kufizues apo ndalues lejon mundësinë e ushtrimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm ankimi.

Ky qëndrim bazohet dhe në argumentin që ligjvënësi në ligjin nr. 84/2016 duket se nuk ka ndjekur një model të një ligji me parashikime shteruese të gjithë të drejtave dhe garancive procedurale të subjekteve të rivlerësimit. Për këtë arsye, neni 4 paragrafi 6 i po këtij ligji ka parashikuar se: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”*. Në referim të përcaktimeve të nenit 4, paragrafi 6 i ligjit nr. 84/2016, nenit 1, paragrafi 2 i ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i

ndryshuar [në vijim “ligji nr. 49/2012”] dhe nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, ligjvënësi ka njohur garancinë procedurale të ushtrimit të rishikimit të vendimit si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi.

5.3. Sa i përket kompetencës lëndore të Kolegjit për rishikimin e vendimit, kam vlerësuar se ajo është e rrjedhur nga fakti që Kolegji është gjykata që ka shqyrtuar në themel ankimin ndaj vendimit të Komisionit. Referuar nenit 497, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Civile *Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel.* Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 ka parashikuar se: [...] Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se: “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”. [...] Ajo duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. [...] **Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislativë dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”⁹.**

Pra, Gjykata Kushtetuese, në interpretimin e saj pajtues për ligjin nr. 84/2016, ka theksuar që pavarësisht se Kolegji është një gjykatë me juridiksion të posaçëm, ai u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vlerësimit, bazuar në një skemë të gjerë legjislativë dhe kushtetuese, duke nënkuptuar dhe pranuar në interpretim harmonik me përcaktimet e nenit 4, paragrafi 6 të ligjit nr. 84/2016, që brenda kësaj skeme legjislativë nuk është vetëm Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, por dhe legjislacioni procedural përkatës, si ligji nr. 49/2012 apo Kodi i Procedurës Civile¹⁰.

5.4. Ndryshe nga shumica, e cila konsideron parashikimin e nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës si dispozitën që kufizon ushtrimin e të drejtës së rishikimit të vendimit, vetëm në

⁹ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, paragrafët 65 dhe 66.

Qëndrimi i Komisionit të Venecias, i referuar nga Gjykata Kushtetuese në këtë vendim është si vijon: “Për sa i përket pyetjes nëse mungesa e mundësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vetting-ut, për të kundërshtuar vendimet e marra nga institucionet e rivlerësimit para gjykatave kombëtare, përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, Komisioni i Venecias konsideron se përgjigjja e kësaj pyetje varet nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në Ligjin e Vetting-ut. Për Komisionin e Venecias, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se Kolegji i Apelit mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili i jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vetting-ut. Të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislativë dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera”.

¹⁰ Nëse referuar nenit 4, pika 6 dhe nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, ligji nr. 49/2012 nuk ka parashikime të posaçme.

rastin/rrethanën e përcaktuar në nenin 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, kam vlerësuar se qëllimi i këtij parashikimi nuk ka qenë kufizimi i rrethanave të rishikimit të vendimit të Kolegjit vetëm në rastet kur GjEDNJ-ja ka marrë një vendim për kërkesën e paraqitur nga vetë subjekti.

5.4.1. Siç kam referuar më sipër në këtë mendim, ligjvënësi në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, subjekteve të rivlerësimit i ka kufizuar të drejtën sipas nenit 131, paragrafi “f” të Kushtetutës, pra, të drejtën për ankim kushtetues individual pranë Gjykatës Kushtetuese. Në vlerësimin tim, parashikimi i nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, ka pasur për qëllim të definojë dhe qartësojë në mënyrë të shprehur se ndryshe nga kontrolli kushtetues i realizuar në Gjykatën Kushtetuese me ankime individuale ndaj vendimeve përfundimtare të sistemit të brendshëm gjyqësor, në juridiksionin e rivlerësimit Kolegji është gjykata e cila përbëhet dhe shqyrtimin e çështjeve, të cilat mund të ngrihen nëpërmjet një ankimi kushtetues individual, ndaj vendimi i tij nuk mund të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese, por në GjEDNJ.

5.4.2. Duket se në të njëjtën mënyrë ka thirrur në interpretim pajtues përcaktimet e nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas së cilit: *“Në lidhje me të drejtën për ankim kushtetues individual, në vlerësimin e Komisionit të Venecias Kushtetuta ka heshtur në lidhje me faktin nëse një subjekt mund të paraqesë një ankim individual para Gjykatës Kushtetuese dhe se në mungesë të një ndalimi nuk ka arsye për të përjashtuar një mundësi të tillë (paragrafi 44 i opinionit CDL-AD (2016)036). Në vlerësimin e Gjykatës, Kushtetuta nuk ka heshtur në lidhje me këtë drejtë, ashtu si edhe për disa të drejta të tjera kushtetuese. Gjykata vëren se, sipas nenit A të Aneksit të Kushtetutës me qëllim kryerjen e këtij procesi kufizohet edhe nënparagrafi “f” i nenit 131 të Kushtetutës, çka nënkupton se ky kufizim lidhet specifikisht me të drejtën e subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kurse sipas nenit F, pika 8, po të Aneksit, subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në GJEDNJ. Vlerësimi nëse ky kufizim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi për sa kohë që ai jo vetëm është vendosur në rang kushtetues, por edhe sepse Gjykata nuk ka juridiksion për vlerësimin në themel të këtyre dispozitave, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutë me anë të një ligji rishikues. Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KA-së si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën”¹¹.*

5.4.3. Nga ana tjetër, në vlerësimin tim, nëpërmjet këtij përcaktimi të nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës, gjen pasqyrim detyrimi i KEDNJ-së, sipas së cilit çdo individ mund të paraqesë një ankim në GjEDNJ, nëse pretendon se ka pasur cenim të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë akt ndërkombëtar të Këshillit të Evropës.

6. Bazuar në sa më sipër, në një interpretim harmonik të përcaktimeve të nenit F, pikat 1 dhe 8 të Aneksit të Kushtetutës¹², nenit 4, paragrafi 6 të ligjit nr. 84/2016, të referuar në paragrafin 5.2

¹¹ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, paragrafi 68.

¹² Kolegji si organi i rivlerësimit, që shqyrton në themel ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, përthith juridiksionin dhe kompetencën rishikuese.

më sipër, si dhe nenit 1, paragrafi 2 i ligjit nr. 49/2012, në konsideratë edhe të mungesës së parashikimeve eksplicite për kufizim të të drejtës së rishikimit vetëm në rrethanën e përcaktuar në germën “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoj se Kolegji ka juridiksion rishikues për të gjitha rrethanat e përcaktuara në këtë dispozitë¹³.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë* në paragrafin 46 të të cilit ka vlerësuar se: *Në mbështetje të nenit 4(6) të Ligjit të Rivlerësimit, lexuar së bashku me nenin 1(2) të ligjit për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”) organet e rivlerësimit, në rrethana të caktuara, mund të zbatojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një palë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, i cili është i formës së prerë në rrethana të caktuara, më konkretisht kur [...]”¹⁴. Në këtë paragraf, GjEDNj-ja rendit të gjitha rrethanat e përcaktuara nga germa “a” në germën “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke mos e kufizuar ushtrimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm ankimi vetëm në rrethanën e përcaktuar në germën “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.*

Gjithashtu, GjEDNj-ja, në po këtë vendim në paragrafin 111, ka theksuar se: *Kërkuesja nuk paraqiti, pas vënies në dijeni për dyshimet në lidhje me përshtatshmërinë e L. D., për pozicionin e tij, një kërkesë për rishikim përjashtimor në vendimin e formës së prerë të KPA-së në çështjen e saj mbështetur në faktet e zbuluara rishtazi, apo për ndonjë shkak tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (shih paragrafin 46 më sipër) [...]*.

7. Bazuar në sa më sipëranalizuar, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelit ka juridiksion rishikues, si dhe është gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë.
8. Sa i përket rrethanës në bazë të të cilës kërkuesi kërkon rishikimin e vendimit të Kolegjit, konkretisht vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 25.10.2022, i cili ka ndryshuar vendimin nr. {***}, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për pjesën e motivacionit që lidhet me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak dorëheqje, kërkuesi ka parashtruar se ky vendim i Gjykatës së Lartë afekton lidhur me shkakun ligjor [dorëheqja], në bazë të të cilit është ndërprerë procesi i rivlerësimit për z. Bilbil Mete, për rrjedhojë cenon bazueshmërinë e vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit, si dhe vendimit nr. 9/2021, datë 23.03.2021, të Kolegjit, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit, bëhen të cënueshëm.

Lidhur me shqyrtimin e kërkesës, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, konkretisht neneve 4, pika 6 dhe 65, pika1, vendimmarrjet e Kolegjit, në kuadër të kompetencave të tij, i nënshtrohen rregullave të legjislacionit procedural mbi gjykimin e ankimit në gjykatën e apelit administrativ, ndaj dhe për këtë kërkesë duhet të zbatoheshin, për aq sa është e mundur dhe e lejuar, rregullat dhe procedurat që kanë gjetur zbatim në dhënien e vendimit objekt rishikimi. Në konsideratë të këtij qëndrimi, në çështjen në fjalë, duhet të gjente zbatim parashikimi i nenit

¹³ Qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji dhe për kërkesat për rishikim vendimi të kërkueseve R. G. dhe A. G.

¹⁴ GjEDNj-ja rendit të gjitha rrethanat e përcaktuara nga germa “a” në germën “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

498 i Kodit të Procedurës Civile, për sa ai referon në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për rishikim nga gjykata e apelit.

Në shqyrtimin të kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës për rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, në referim të përcaktimeve të pikës 1 të nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohen të papranueshme rastet të cilat janë jashtë përcaktimeve të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile apo kur ajo është haptazi e pambështetur.

9. Në konsideratë të sa më sipër, pas shqyrtimit të përmbajtjes së kërkesës së z. Bilbil Mete dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, kam vlerësuar se kjo kërkesë referonte rrethana të cilat ishin brenda parashikimeve të nenit 494, germa “a”, sipas së cilës një kërkesë për rishikim mund të paraqitet nëse *zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihenin nga pala gjatë shqyrtimit të saj.*

Në vlerësim të vendimit të Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 25.10.2023, kam konkluduar që ky akt është një provë e re që ka rëndësi për çështjen, e cila nuk mund të dihej nga kërkuesi, z. Bilbil Mete, në momentin që në Kolegj po shqyrtohej çështja e tij në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit¹⁵, për rrjedhojë plotësonte një nga kërkesat e parashikuara në nenin 494, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile.

Sa i përket rëndësisë së saj si një rrethanë e theksuar në përcaktimin e mësipërm ligjor, dhe nëse marrja e kësaj prove do të sillte një vendimmarrje të ndryshme të Kolegjit, pra, do të afektonte vendimin e marrë për çështjen e tij të juridiksionit të rivlerësimit, duke qenë se shumica, pavarësisht qëndrimit për mungesë të juridiksionit rishikues dhe kompetencës lëndore të Kolegjit për kërkesat për rishikim, ka elaboruar në paragrafët 12-16 të vendimit argumentet përse edhe në versionin që kjo kërkesë për rishikim do të shqyrtohej ajo përsëri do të ishte e papranueshme, po paraqes në vijim në mënyrë të përmbledhur vlerësimin tim, i cili është në vijim dhe të qëndrimeve në pakicë të mbajtura më parë prej meje¹⁶.

10. Ndryshe nga shumica, kam vlerësuar se Kolegji nuk ka juridiksion të vlerësojë lidhur me shkakun ligjor të mbarimit të statusit të subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur referuar nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është Këshilli i Lartë i Prokurorisë [në vijim KLP] organi kompetent për vendimmarrjen lidhur me të.

Për sa i takon kontrollit gjyqësor të aktit administrativ individual të KLP-së, në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit, referuar nenit 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, këtë kompetencë e ka Gjykata Administrative e Apelit. Në vlerësimin tim, gjatë shqyrtimit në Kolegj vendimi i KLP-së ndodhej në proces kontrolli përmes rekursit të ushtruar në Gjykatën e Lartë, ndaj Kolegji duhet të pezullonte *ex officio* gjykimin e çështjes deri në përfundimin e kontrollit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

¹⁵ Vendim i cili është marrë pas vendimit të Kolegjit për çështjen e tij të juridiksionit të rivlerësimit.

¹⁶ Vendimi nr. 30 (JR), datë 11.11.2020, si dhe vendimi nr. 4 (JR), datë 12.02.2021.

Gjithashtu, kam vlerësuar se Kolegji nuk mund të përthithë kompetencën që ligjvënësi shprehimisht ia ka dhënë Gjykatës Administrative të Apelit apo në rast rekursi Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me interpretimin se në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, ai mund të bëjë edhe zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje gjyqësore administrative, që ka lidhje të drejtpërdrejtë me këtë proces. Në gjykimin tim, i takon vetëm këtyre gjykatave¹⁷ të vlerësojnë nëse padia, e cila i është paraqitur për gjykim nga subjekti i rivlerësimit, është apo jo në juridiksionin dhe kompetencën e tyre.

Gjithashtu, kam gjykuar se në rastin e kërkuarit, z. Bilbil Mete, vlerësimi për shkakun ligjor, i cili ka passjellë dhe mbarimin e statusit të magjistratit për të, ka qenë objekt kontrolli në Gjykatën Administrative të Apelit Administrativ, si dhe në Gjykatën e Lartë në momentin kur po shqyrtohej ankimi i tij në Kolegji. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, ndaj të cilit ishte ushtruar rekurs nga subjekti i rivlerësimit¹⁸, mund të kontrollohej duke qenë se ishte kundërshtuar prej këtij të fundit vetëm nga Gjykata e Lartë. Vendimi i Gjykatës së Lartë, për asnjë arsye, nuk mund të mos njihet dhe mos zbatohet nga Kolegji, lidhur me shkakun ligjor të mbarimit të statusit të magjistratit. Ky arsyetim dhe qëndrim i imi në pakicë bazohet edhe në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës, në trajtimin e çështjeve të ngjashme prej tij, si një nga parakushtet procedurale për marrjen e vendimeve në rastet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, në kuadër të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka vlerësuar të domosdoshme që vendimet e organeve kompetente [sipas rastit KLGj ose KLP], lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit të kenë marrë formë të prerë. Nëse qëndrimi i Kolegjit do të ishte i ndërruar vetëm nga shprehja e vullnetit për të hequr dorë nga procesi i rivlerësimit, dhe jo nga shkakun ligjor në bazë të të cilit është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit nga organi kompetent, atëherë do të ishte i panevojshëm konfirmimi që këto akte kishin marrë formë të prerë.

Bazuar në sa më sipër, kam konkluduar se në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 25.10.2023, ka disponuar se shkakun ligjor i mbarimit të statusit të magjistratit nuk është dorëheqja, por ushtrimi i të drejtës për të dalë në pension nga kërkuari, z. Bilbil Mete, ky disponim do të kishte rëndësi në drejtim të vendimmarrjes së Kolegjit në konsideratë të përcaktimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe pasojave të parashikuara në të për subjektet e rivlerësimit.

11. Në përfundim, bazuar në nenin 498, pika 1 dhe nenin 494, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në sa kam arsyetuar e konkluduar më sipër, kam çmuar se kërkesa e z. Bilbil Mete nuk ishte në kushtet e mospranueshmërisë, pra, ajo duhej të pranohej. Sa i takon mënyrës së shqyrtimit të kësaj kërkeje nga Kolegji, pasi ai të merrte vendim për pranimin ose jo të saj¹⁹, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese²⁰ dhe Gjykatës së Lartë²¹, me

¹⁷ Gjykata e Lartë në eventualitetin e ushtrimit të së drejtës së kontrollit ndaj këtij vendimi gjyqësor nëpërmjet rekursit.

¹⁸ Në këtë cilësi në momentin e shqyrtimit të ankimit në Kolegji.

¹⁹ Sipas nenit 498, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile.

²⁰ Vendimi nr. 4, datë 25.02.2009, vendimi nr. 5/2007, të Gjykatës Kushtetuese.

²¹ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1/2006.

qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, Kolegji do të duhej të vijonte shqyrtimin e saj në seancë publike për t'i dhënë të drejtës kërkuarit të dëgjohej lidhur me themelin e saj.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi